

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave të Natyrës
Departamenti i Informatikës

Udhëzim mbi shkrimin e mikrotezës

*Drejtuar studentëve diplomantë të
Masterave Shkencorë dhe Profesionalë të
ofruar nga Departamenti i Informatikës*

Tiranë, më 10.01.2014

Përmbajtje

- [1. Çfarë është mikroteza?](#)
- [2. Proçesi i punimit të mikrotezës](#)
 - [2.1 Faza fillestare](#)
 - [2.2 Faza e ndërmjetme](#)
 - [2.3 Faza finale](#)
- [3. Struktura e dokumentit të mikrotezës](#)
- [4. Formati tekstual i mikrotezës](#)
- [5. Kriteret minimale që duhet të përmbushë një punim mikroteze](#)
- [6. Prezantimi final](#)
- [7. Lidhje të dobishme](#)
 - [7.1 Motorë kërkimi për artikuj shkencorë:](#)

1. Çfarë është mikroteza?

Mikroteza është një punim individual që përmbyll studimet e një studenti të Masterit Shkencor. Nëpërmjet mikrotezës çdo diplomant duhet të vërë në dukje aftësitë e aplikimit të njohurive informatike në një projekt relativisht më të madh se ato që është hasur gjatë viteve të studimit. Pas përfundimit të punës rreth mikrotezës studenti dorëzon një punim të shkruar 60-100 faqe si dhe i nënshtrohet mbrojtjes së mikrotezës përpara komisionit përkatës me anë të një prezantimi final. Në mënyrë që të pranohet në prezantimin final, studenti duhet të ketë përmbushur të gjithë detyrimet e tjera të Masterit Shkencor apo Profesional (të ketë grumbulluar të gjitha kreditet përkatësisht 90 dhe 60 kredite).

Punimi i mikrotezës duhet të ofrojë zgjidhjen e një problemi konkret nëpërmjet informatikës. Problemet mund të jenë nga fusha të ndryshme aplikimi, p.sh. sisteme biznesi, situata sociale, aplikime akademike etj. Zakonisht mikroteza përfshin zhvillimin e një prototipi konkret të zhvilluar nëpërmjet një teknologjie (ose disa) të caktuar. Punimi i shkruar përmban përshkrimin e bazës teorike mbi të cilën po zhvillohet teza, shtrimin e problemit dhe dokumentimin e plotë teknik të zgjidhjes së ofruar.

Në qendër të hulumtimit duhet të jetë një analizë e detajuar e problemit që duhet zgjidhur si dhe metodave informatike që janë përdorur. Edhe në rastin kur punimi i diplomës është shumë praktik (konsiston në programimin e një programi konkret), punimi i mikrotezës së një Masteri Shkencor apo Profesional duhet të përmbajë një analizë të detajuar të fushës së aplikimit, p.sh. të përshkruajë punë të tjera të ngjashme si dhe metodologji të ndryshme që janë në dispozicion.

Rezultatet e mikrotezës duhet të përbëjnë një kontribut sado minimal në lidhje me një ose disa fusha të informatikës. Si rrjedhojë ato duhet të jenë të evidentuara qartë dhe në një mënyrë

sistematike në punimin e shkruar si dhe në prezantimin final.

2. Proçesi i punimit të mikrotezës

Proçesi i punimit të mikrotezës fillon me përzgjedhjen e temës. Çdo vit, Departamenti i Informatikës shpall temat e ofruara nga pedagogët e departamentit të cilat janë të orientuara ndaj fushave kërkimore të secilit prej tyre. Megjithatë secili student është i lirë të vihet në kontakt me pedagogët paraprakisht në rast të dëshirës së paraqitjes së një ideje konkrete teme.

Çdo student duhet të kontaktojë me pedagogët që kanë propozuar tema që i përshtaten interesave dhe aftësive personale. Pas rënies dakord për udhëheqje nga një pedagog i caktuar në lidhje me një temë, përzgjedhja e temës zyrtarizohet me dorëzimin në Sekretarinë e Departamentit të Informatikës, të titullit dhe abstraktit të temës, të firmosur nga studenti dhe pedagogu udhëheqës. Një kopje të dokumentit e mban pedagogu dhe një tjetër e mban studenti. Në këtë hap zyrtarizohet përveç temës edhe mentori ose udhëheqësi i studentit. Pas dorëzimit të këtij dokumenti, nuk është e mundur që studenti të ndryshojë temën deri në sezonin pasardhës të mbrojtjes së mikrotezës.

Proçesi i punimit të një mikroteze përfshin raportimin dhe konsulencën e herëpashershme me udhëheqësin e temës me një periudhë kohore midis raportimeve për të cilën bien dakort studenti me udhëheqësin. Kjo mënyrë garanton që studenti është në rrugën e duhur, si dhe rrit mundësinë e prodhimit të një punimi cilësor deri në përfundim të punës. Është e kuptueshme që mungesa e komunikimit rrit mundësinë e gabimeve si dhe nuk garanton cilësinë e produktit final të mikrotezës duke sjellë një mundësi të madhe për mos aprovim të punimit nga udhëheqësi.

2.1 Faza fillestare

Pas zyrtarizimit të përzgjedhjes së temës, studenti mund të fillojë nga puna konkrete. Studentët janë të lirë të fillojnë nga puna përpara afatit të përcaktuar për punimin e mikrotezës. Sugjerohet që çdo student të realizojë një takim fillestar me udhëheqësin e tij, në mënyrë që të bëhen të qarta objektivat e temës si dhe çfarë pritet konkretisht të realizojë studenti. Në mënyrë që të shmangen keqkuptime në fazat e mëtejshme, studenti mund të hartojë një dokument të shkurtër që përshkruan problemin dhe detyrat e temës nga këndvështrimi i studentit. Kjo siguron që udhëqësi dhe studenti po punojnë në të njëjtën linjë.

Në varësi të njohurive paraprake që ka studenti, zakonisht hapat e parë të punimit të mikrotezës përfshijnë një fazë orientuese që konsiston në veprimtaritë e mëposhtme:

- Konsultimi me literaturën mbështetëse si dhe punë të ngjashme (related works)
- Ambientimi me teknologjitë dhe ambientin e punës ku do zhvillohet prototipi
- Përcaktimi më i qartë i problemit që duhet të zgjidhet nëpërmjet kësaj mikroteze
- Studimi i disa alternativave të mundshme të zgjidhjeve si dhe vendimi i argumentuar për

- qasjen që do ndiqet
- Një plan pune i mirëplanifikuar për hapat e mëtejshëm

Pas përfundimit të fazës orientuese këshillohet të realizohet një takim i ndërmjetëm me udhëheqësin në mënyrë që të diskutohen konkluzionet e arritura deri në këtë moment si dhe të mirëpërcaktohen hapat e radhës. Është shumë e rëndësishme që në përfundim të kësaj faze të jetë përcaktuar pothuajse në formë përfundimtare lista e referencave që do përdoren për punimin e mikrotezës.

2.2 Faza e ndërmjetme

Faza e ndërmjetme zakonisht fokusohet në zhvillimin e prototipit konkret që po realizohet për mikrotezën në fjalë. Në këtë fazë bëhet i qartë konteksti i biznesit, kërkesat e sistemit apo prototipit që po implementohet, përshkrimin e arkitekturës së zgjidhjes, dokumentimin e zhvillimit, etj. Këshillohet që gjatë kësaj faze studenti të realizojë kontakte të herëpashershme me udhëheqësin e tij, në mënyrë që të shmangen keqkuptime të mundshme ose të lehtësohet zgjidhja e problemeve të natyrave të ndryshme.

Vlerësimi i mikrotezës nuk bazohet vetëm mbi saktësinë e zhvillimit (implementimit) dhe përshkrimin në dokumentin e shkruar, por dhe në autonominë e studentit në lidhje me përcaktimin e temës, përzgjedhjen e literaturës apo gjetjen e zgjidhjeve. Fokus i veçantë vihet mbi vendimet e dizenjimit që mund të ketë marrë studenti gjatë punimit të temës, bazuar në një këndvështrim informatik.

Nëse tema përfshin eksperimente, një pjesë e tyre mund të zhvillohen në këtë fazë. Gjithashtu në rastin e zhvillimit të programeve konkrete gjatë punimit të mikrotezës, këshillohet që versione të ndërmjetme të konsultohen me përdorues potenciale apo edhe me udhëheqësin e temës.

2.3 Faza finale

Në fazën finale, realizohet shkrimi i punimit të mikrotezës. Megjithatë një pjesë e studentëve mund të preferojnë që procesin e të shkruarit ta nisnin që në fazat e para duke bashkërenduar punën me dokumentimin, sidomos kapitujt që dokumentojnë literaturën e përdorur. Gjithsesi, përgjithësisht kapitujt që përshkruajnë kontributin konkret të studentit, bëhet e mundur të shkruhen pikërisht në këtë fazë, pra pas përfundimit të programimit.

Duhet theksuar që ***punimi i shkruar nuk është një dokumentim i programit apo prototipit të krijuar***. Ai duhet të tregojë aftësitë e studentit për të aplikuar apo zhvilluar metodat e informatikës në mënyrë autonome. Duhet të jetë e qartë se cila është pjesa që është marrë nga literatura si dhe cila është puna konkrete që ka realizuar studenti.

Punimi pothuajse përfundimtar duhet t'i dërgohet udhëheqësit në kohë, në mënyrë që të jetë i mundur rishikimi i tij apo të bëhen ndryshime në lidhje me probleme të mundshme që mund të

identifikojë udhëheqësi.

Punimi i përfunduar duhet të dorëzohet në Sekretarinë e Departamentit të Informatikës i firmosur nga studenti dhe udhëheqësi. Numri i kopjeve që duhet të dorëzohen si dhe data maksimale e dorëzimit përpara çdo sezoni shpallen përpara në kohë nga Departamenti i Informatikës. Përgjithësisht, për sezonet e rregullta afati maksimal i dorëzimit të punimit të shkruar të mikrotezës në Departament është dy javë para datës së prezantimeve finale të diplomave.

3. Struktura e dokumentit të mikrotezës

Më poshtë mund të gjeni një mundësi për strukturimin e mikrotezës. Tema duhet të jetë 60-100 faqe. Emrat e kapitujve nuk janë strikte, pasi në varësi të temës mund të ketë strukturime të ndryshme. Megjithatë mund të përbëjë një bazë fillestare të mirë për të strukturuar punën dhe idetë tuaja në mënyrë lineare. Kapitujt e mëposhtëm gjithashtu mund të ndahen nëse gjykohet e arsyeshme.

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje

a. Përshkrimi i problemit

Në këtë paragraf përshkruhet problemi në detaje si dhe vihet në dukje rëndësia e zgjidhjes së tij.

b. Detyrat e kësaj teme

Duhet të bëhet e qartë se çfarë pretendohet të realizohet me këtë temë si dhe zgjidhjet që duhet të ofrohen.

2. Përshkrim i literaturës

a. Përshkrim i literaturës së grumbulluar për këtë temë

Një mikrotezë e një Masteri Shkencor apo Profesional duhet të mbështet mbi një literaturë të përshtatshme në lidhje me temën konkrete. Në këtë paragraf përshkruhet literatura që do përdoret si dhe vihen në dukje alternativa të ndryshme (p.sh. disa algoritma) që mund të ofrojnë zgjidhje të mundshme.

Duke qenë se në këtë pjesë përshkruhen përgjithësisht punët e të tjerëve, bëni kujdes që të jetë e qartë që ky nuk është produkti juaj. Çdo fakt duhet të jetë i referuar ndaj listës së referencave dhe duhen përdorur shprehje të tilla si: "Në punimin X, Johnson dhe Johanson vënë në dukje se.., Sipas Albert [7], arrihet

që..., Jacob et al., përshkruajnë një metodë për gjetjen e Z në punimin X., etj.”

b. Dokumentacion i teknologjive

Në këtë pjesë dokumentohen teknologjitë që do përdoren për zhvillimin e prototipit (programit) që përfshin mikroteza. Është me rëndësi që të përfshihen këtu të gjithë pjesët që mund t'i referohesh në kapitujt e mëvonshëm.

c. Punë të tjera në lidhje me këtë temë

Nëse gjatë konsultimit me literaturën, keni evidentuar punë të tjera të ngjashme në lidhje me këtë temë, është me interes që ato të përfshihen në punimin e shkruar të mikrotezës. Kjo është pjesë e kontributit tuaj, por bëni kujdes që gjithnjë t'i referoheni punëve origjinale përkatëse.

3. Modelimi i zgjidhjes

a. Konteksti i biznesit

Në këtë paragraf përshkruhen konteksi i biznesit mbi të cilën po ndërtohet zgjidhja (programi, prototipi) juaj.

b. Rastet e përdorimit/kërkesat

Në këtë paragraf përshkruhen kërkesat funksionale dhe jo funksionale të programit apo prototipit që po ndërtoni. Mund të përshkruhen me template tekstual për inxhinierimin e kërkesave apo dhe me diagrama use case UML.

c. Modelimi i të dhënave

Nëse zgjidhja juaj përfshin një bazë të dhënash, ky është paragrafi ku përshkruhet struktura e kësaj të fundit.

d. Arkitektura fizike

Në këtë pjesë përshkruhet arkitektura fizike e zgjidhjes tuaj. Pra pjesët hardware që përdoren dhe lidhjet ndërmjet tyre. Arkitektura që përdoret më shpesh është ajo klient-server, por kjo varet nga tema konkrete.

e. Arkitektura logjike

Në këtë pjesë përshkruhen pjesët përbërëse të sistemit, pra modulet (nënsistemet) e dizenuara pas dekompozimit funksional. Është e rëndësishme të përshkruhen në detaje gjithsecili si dhe marrëdhëniet që ato kanë ndërmjet tyre.

4. Zhvillimi

a. Teknologjitë e përdorura

Këtu vihen në dukje të gjithë teknologjitë që janë përdorur për programimin e zgjidhjes tuaj duke përmendur çdo detaj përfshirë emrin e teknologjisë, versionin dhe prodhuesin dhe duke sqaruar se me çfarë gjuhe programimi është punuar. Është me rëndësi të përshkruhen probleme që hasët gjatë zhvillimit si shkak i teknologjive të përdorura.

b. Detaje mbi zhvillimin

Nuk preferohet që të vendoset kodi i plotë i zgjidhjes tuaj në dokumentin e shkruar. Përgjithësisht në këtë pjesë vendosen diagrama të ndryshme, p.sh. diagramë klasash, diagrama aktiviteti, diagrama rrjedhe të dhënash (data flow), etj.

Megjithatë, nëse shihet e arsyeshme që të dokumentohen pjesë kyçe të programit tuaj, p.sh. algoritma, kërkesa SQL të avancuara, etj. ky është vendi përkatës ku mund të dokumentohen dhe të jenë të shoqëruara me komente dhe sqarime përkatëse për të identifikuar rëndësinë e asaj pjese të kodit në zgjidhjen e problemit të parashtruar për tu zgjidhur në prototip.

c. Dokumentimi i vendimeve kyçe të marra gjatë zhvillimit

Është shumë e rëndësishme të vihen në dukje vendime kyçe që janë marrë gjatë zhvillimit të zgjidhjes së dizenuar nga ju. Kjo është pjesë e kontributit tuaj si dhe mund të ndihmojë studentë të tjerë që duan të punojnë në fusha të ngjashme me temën tuaj. Ky është paragrafi ku vihen në dukje këto punime.

5. Rezultate/Konkluzione

Në këtë seksion përmbledhen rezultatet e punës tuaj, duke përfshirë problemet që hasët si dhe ato që u arritën. Pjesë e vlerësimit janë dhe aftësitë konkluduese të studentit të cilat duhet të reflektohen në këtë pjesë. Kini parasysh që hyrja dhe konkluzionet janë pjesët më të lexuara të një punimi akademik. Kjo vlen edhe për mikrotezën.

6. Punë që mund të zhvillohen në të ardhmen (në lidhje me temën)

Në rast se ju gjatë punës për temën keni vënë re se ka vend për punë të mëtejshme në lidhje me këtë temë në të ardhmen ato përshkruhen në këtë seksion.

7. Referenca/Bibliografi

Rendisni te gjitha referencat (te pakten 5), artikuj ose libra qe keni perdorur ne lidhje me mikrotezen tuaj, si ne shembullin e meposhtem.

Bëni kujdes që në tekst referencave të listuara t'i referoheni me shënime numerike, p.sh. [1], [2], [3] sipas rradhës së shfaqjes ose (Emër Autori(ësh), Viti), p.sh. (Aitken et al., 1999)

- Aitken, B. J. & A. E. Harrison (1999): Do Domestic Firms Benefit from Direct Foreign Investment? Evidence from Venezuela. *American Economic Review* 89(3): pp. 605–618.
- Bjorvatn, K. & C. Eckel (2006): Policy Competition for Foreign Direct Investment between Asymmetric Countries. *European Economic Review* 50(7): pp. 1891–1907.
- Blomström, M. & A. Kokko (2003): The Economics of Foreign Direct Investment Incentives. *NBER Working Papers 9489*, National Bureau of Economic Research.
- Blundell, R. & S. Bond (1998): Initial Conditions and Moment Restrictions in Dynamic Panel Data Models. *Journal of Econometrics* 87(1): pp. 115–143.
- Castellani, D. & A. Zanfei (2007): Multinational Companies and Productivity Spillovers: Is There a Specification Error? *Applied Economics Letters* 14(14): pp. 1047–1051.
- Görg, H. & E. Strobl (2001): Multinational Companies and Productivity Spillovers: A Meta-analysis. *Economic Journal* 111(475): pp. 723–39.
- Haaparanta, P. (1996): Competition for Foreign Direct Investment. *Journal of Public Economics* 63(1): pp. 141–53.
- Haufler, A. & I. Wooton (2006): The Effects of Regional Tax and Subsidy Co-ordination on Foreign Direct Investment. *European Economic Review* 50(2): pp. 285–305.
- Javorcik, B. S. (2004): Does Foreign Direct Investment Increase the Productivity of Domestic Firms? In Search of Spillovers through Backward Linkages. *American Economic Review* 94(3): pp. 605–627.
- Stanley, T. D. (2001): Wheat from Chaf: Meta-analysis as Quantitative Literature Review. *Journal of Economic Perspectives* 15(3): pp. 131–150.

4. Formati tekstual i mikrotezës

Mikroteza duhet të paraqitet në një dokument me 60-100 faqe, ku përfshihen edhe kopertina (kapaku i dokumentit) dhe faqja e fundit. Dokumenti duhet të dorëzohet në format libri si në figurë:



ku në kopertinën e librit (cover) të vendoset ekzaktësisht si më poshtë emri i studentit diplomant, emri i udhëheqësit dhe tema e diplomës si në vijim.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
DEGA: INFORMATIKË**

**Mikrotezë për mbrojtjen e gradës “Master i Shkencave” (MSC)
Tema: “Tema e përzgjedhur për tu zhvilluar”**

**Punoi
Emër Mbiemër**

**Udhëhoqi
Grada. Emër Mbiemër**

Në faqen e parë të punimit do të vendoset shkrimi si vijon ku do të firmosin diplomanti dhe udhëheqësi. Gjithashtu duhet të jenë prezente dy logot, logoja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe logoja e Universitetit të Tiranës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
DEGA: INFORMATIKË

Mikrotezë për mbrojtjen e gradës “Master i Shkencave” (MSC)

Tema: “Tema e përzgjedhur për tu zhvilluar”

Punoi
Emër Mbiemër
(_____)

Udhëhoqi
Grada. Emër Mbiemër
(_____)

Tiranë, më ____ / ____ / ____

4.1 Udhëzime për stilin e shkrimit

4.1.1 Pikësimi

- Vendosni presje kur ka një pauzë ndërmjet fjalëve ose shprehjeve në fjalinë e thënë.
- Vendosni pikëpresje ndërmjet dy pjesëve të një fjalie; duhet të keni parasysh që të dyja pjesët të mund të rinë veç si fjali.
- Përdorni dy pikëshin për të dhënë një sqarim apo një shembull.
- Shmangni kllapat rrumbullake, për të bërë një vlerësim që nuk ka shumë kuptim të vendosni presje. Mos përdorni asnjëherë kllapa midis kllapave.
- Përdor kllapat [] për citime dhe referenca.
- Përdor një ose dy hapësira pas presjeve dypikëshave dhe pikëpresjeve.
- Përdorni thonjzat dyshe (") për dialog dhe citime.
- Përdorni thonjzat teke (') për citime brenda citimit.
- Përdorni apostrofin në rast shkurtimesh si për shembull (') "t'ia"
- Vendosini presjet, pikëpresjet apo dypikëshin pas mbylljes së thonjzave teke apo dyshe.
- Përdorni forward slash (/) në vend të ose për të shmangur përsëritjen.
- Përdor Title Case (shkronjë kapitale në fillim të çdo fjale për fjalë me më tepër se 3 shkronja) në rastet e mëposhtme:
 - titujt dhe nëntitujt e punimit tuaj;
 - titujt e referencave;
 - emrat e përveçëm përfshirë këtu edhe markat;
 - emrat e testeve;
 - emrat e shoqëruar nga numrat (në Ditën 2, në Grupin B);
 - emrat e departamenteve institucionale (Departamenti i Informatikës, Universiteti i Tiranës), por jo për disiplinat (një departament informatike);
 - referenca për seksione të punimit (në seksionin e Metodave; shiko Rezultatet; në Figurë 1; në Tabelën 2).

4.1.2 Ndarjet me vijë në mes

- Kujdes përdorimin e tog-fjalëshave të cilët ndahen me vijë në mes si për shembull *njëri-tjetri* etj.
- Gjithashtu: *teste 2-, 5-, dhe 10-minutëshe*.

4.1.3 Italiket dhe Boldet

- Përdorni *italics* për të vënë në pah një shënim dhe **bold** për të theksuar një shprehje. Shmangni *italic bold*.
- Vendosni titullin e një paper, libri, ose reviste në italic në trupin e tekstit. Në listën e referencave, titujt e paperave janë në normal case.
- Vendosni headings në **BOLD UPPER CASE**.
- Vendosni subheadings në **Bold Title Case**.

- Vendosni sub-subheadings në Plain Title Case.
- Mos përdorni italic për fjalë të huaja dhe shkurtime në gjuhë shkencore si për shembull: *via*, *ad hoc*, *post hoc*, *a priori*, *aposteriori*.

4.1.4 Fontet

- Fontet që duhet të përdorni janë: Times New Roman për trupin e tekstit, dhe Arial (PC) ose Helvetica (Mac) për headings dhe subheadings.
- Line Space duhet të jetë 1.5
- Margins duhet të jenë: Top, Bottom, Left, Right 1".

4.1.5 Shkurtime dhe akronimet

- Një shkurtime ose akronim (emër i shkurtër) përdoret vetëm në rastet kur shprehja e plotë është shumë e gjatë ose shkurtime është i njohur në fushën e kërkimit. Edhe në këto raste duhet të përdoret një formë e shkurtër e thjeshtë për tu kuptuar.
- Nëse do të përdoret një shkurtime atëherë kur të përdoret për herë të parë duhet të vendoset midis kllapave pas përcaktimit të parë të shprehjes së plotë: për shembull, body mass index (BMI).
- Përdorni vs (versus) brenda ose jashtë kllapave pa e përcaktuar atë si fjalë.
- Mos përdorni pika ose hapësira në shkurtime dhe emrave të shteteve: US, UK.
- Përdorni pikë vetëm nëse shkronja e fundit e shkurtime nuk është shkronja e fundit e fjalës, si në shembujt: Prof., Dr, Mr, Ms, Vol. 1, p. 3, p. 23-25, vs, etj., e me rradhë.
- Përdorni shkurtime ndërkombëtare të Systeme Internationale (SI) për njësitë matëse si më poshtë:

metër m	milisekonda ms
gram g	sekonda s
kilogram kg	minuta min
mole mol	orë h
liter L (jo l)	ditë d
mililiter ml	javë wk
shkallë °C	vit y

- Përdorni shënimin ml·min⁻¹·kg⁻¹ për akademikët dhe ml/min/kg për jo-akademikët.

4.1.6 Headings, stilet e paragrafeve dhe listat

- Duhet të përdoren heading, subheading, font, dhe stile paragrafesh të përshtatshme në lidhje me punimin që do të paraqitni. Më poshtë ndodhet shembulli me ato më kryesoret:

TITULLI I DOKUMENTIT: Nëntitull opsional 14-pt Arial

HEADING në 11-pt Arial

Subheading në 11-pt Arial

Sub-subheading në 11-pt Arial

Paragrafi i parë në 11-pt Times New Roman...

- Përdorni pikat e zeza kur doni të vendosni në listë elemente të paraqitura me fjali të plota, përveç rastit kur listoni hapa proceduralë.

4.1.7 Numrat

- Përdor tildën (~) për të nënkuptuar *afërsisht e barabartë me*.
- Numrat në fjali duhet të shkruhen me gërma.
- Vendosni një hapësirë ndërmjet numrave dhe njësive: shembull, 75 kg. Përrjashtim: 75%.
- 0.32, jo .32.
- Sigurohuni që shifrat e numrit dhe ato të devijimit standart të jenë konsistente. Shembuj: 20 ± 13 ; 0.020 ± 0.013 ; 156 ± 7 ; 1.56 ± 0.07 ; 15600 ± 700 .

4.1.8 Tabelat


- Tabelat duhet të krijohen si të tilla në word dhe nuk duhet të përdoren tabet për të simuluar tabelat.
- Shembull:

Titulli i tabelës		
A	B	C
D	E	F

-Shënime sqaruese

4.1.9 Figurat

- Figurat duhet të paraqiten si në shembullin e mëposhtëm:



5. Kriteret minimale që duhet të përmbushë një punim mikroteze

Duke qenë se mikroteza është punimi që përmbyll studimet e një studenti masteri, dhe kjo e fundit ngarkohet me një numër të konsiderueshëm kreditesh, është e domosdoshme që çdo mikrotezë e paraqitur në Departament të përmbushë disa kriteret minimale. Më poshtë po i përshkruajmë këto:

- Tema duhet të jetë e shkruar në shqipe korrekte, që zbaton rregullat e drejtshkrimit, si dhe përdor të gjithë shkronjat që përmban shqipja (përfshirë ë, ç, Ë, Ç). Bëni kujdes që lidhëza “i” të mos jetë shkruar e madhe pra “I”.
- Paragrafët duhet të jenë të ndarë qartë dhe sipas rregullave të drejtshkrimit.
- Dokumenti i dorëzuar duhet të ketë një strukturë të qartë, me lidhje logjike midis seksioneve dhe të konsultuar paraprakisht me udhëheqësin.
- Duhet të jetë e qartë se cila pjesë e temës është përshkrim i literaturës dhe cila është puna konkrete e realizuar nga diplomanti.

- Çdo paragraf, fjali apo fakt që bazohet mbi literaturën mbështetëse duhet të pajisjet me referencën përkatëse. Paragrafët që përshkruajnë punën e të tjerëve duhet të shkruhen në formë të tillë: “X autor vë në dukje.., Në punimin Y gjendet.., Autorët A dhe B kanë përshkruar, Autori D et al. (me të tjerë) kanë realizuar.., etj.”
- Punimi duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të literaturës dhe dokumentacionit të teknologjive të përdorura. Bashkëngjitur duhet të jetë dhe një analizë kritike e atyre që përshkruhen.
- Çdo artikull apo libër i paraqitur si literaturë, duhet të jetë referuar të paktën një herë. Pra nuk duhet të ketë punime që nuk janë përdorur apo referuar në listën e literaturës që ndodhet në fund të dokumentit
- Punimi duhet të shpalosë në mënyrë të qartë konkluzionet
- Dokumenti i shkruar duhet të ketë përdorur rregullat e formatimit të shpalluara nga Departamenti i Informatikës
- Mikroteza **duhet të jetë firmosur paraprakisht nga udhëheqësi i saj**

KUJDES: Në rast të evidentimit të rasteve të plagjiaturës së theksuar studenti përjashtohet menjëherë nga e drejta e prezantimit të mikrotezës.

6. Prezantimi final

Prezantimi final realizohet para komisionit përkatës në ditën e përcaktuar për çdo sezon provimesh ku mund të bëhet paraqitje diplome. Prezantimi zakonisht zgjat 10-15 minuta duke përfshirë dhe pyetje të mundshme të bëra nga komisioni. Më poshtë mund të gjeni një mënyrë të organizimit të prezantimit (përfshirë slidet shoqëruese):

1. Një përshkrim i shkurtër i problemit
2. Një përshkrim i shkurtër i literaturës së referuar apo teknologjive të përdorura
3. Prezantimi i zgjidhjes dhe i vendimeve të dizenjimit (deri në një farë shkalle)
4. Nëse është e mundur, një rast studimi mbi aplikimin e zhvilluar

Prezantimi mund të përmbajë dhe një demo të shkurtër të prototipit apo programit të ndërtuar. Dy pikat e fundit **janë shumë më të rëndësishme se dy të parat**, si rrjedhojë pjesa më e madhe e prezantimit duhet të përqëndrohet tek ato. Pyetjet nga komisioni mund të bëhen edhe gjatë prezantimit (jo vetëm në fund), kështu që studentët duhet të jenë të përgatitur për këtë.

Duke qenë se koha është shumë e kufizuar, këshillohet që çdo student të realizojë të paktën një prezantim provë përpara se të paraqitet para komisionit. Në këtë mënyrë sigurohet që mund ta përmbyllë prezantimin brenda kohës së lejuar, dhe shmang probleme të mundshme që mund të ndodhin kur e realizon një prezantim për herë të parë.

Bëni kujdes: në rast të tejkalimit të minutave të përcaktuara, komisioni është i detyruar të përfundojë prezantimin edhe në rast se ai nuk ka përfunduar akoma. Supozohet që prezantimi

është përgatitur nga studenti paraprakisht dhe ky i fundit është siguruar që ai mund të përmbillet brenda minutave të lejuara.

7. Lidhje të dobishme

Më poshtë mund të gjeni të listuara disa lidhje të dobishme gjatë punës për shkrimin e mikrotezës tuaj

7.1 Motorë kërkimi për artikuj shkencorë:

<http://scholar.google.com/>

<http://citeseerx.ist.psu.edu/>

<http://arxiv.org/>

<http://academic.research.microsoft.com/>